

**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
**Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**

## **KRYETARI I KOMUNËS**

### **F T E S Ë**

Të nderuar anëtarë/e të zgjedhur dhe certifikuar të Kuvendit të Komunës së Podujevës,

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen inauguruese të Kuvendit të Komunës së Podujevës, e cila do të mbahet më datë **01 dhjetor 2025**.

Gjithashtu, Ju njoftoj se me këtë rast do të bëni betimin dhe do të nënshkruani deklaratën solemne për marrjen e detyrës së anëtarit/ës të Kuvendit të Komunës së Podujevës.


Mbledhja fillon në orën **10:30** në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës në ndërtesën e re.

**Shtojcë: Rendi i ditës**

**21 nëntor 2025**  
**Podujevë**



**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Bulliqi**



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 42.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L- 040, në pajtim me nenin 4 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015 për mbajtjet e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenin 36.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, nenin 5 paragrafët 1 dhe 2 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Podujevës nr.01/146-11 të datës 29 prill 2010, dhe duke u mbështetur në Vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të datës 03.11.2025 për Certifikimin e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve lokale 2025 për Kryetar Komune në Podujevë, si dhe Vendimin e datës 21.11.2025 për Certifikimin e rezultateve përfundimtare për zgjedhjet lokale për kuvendet komunale,

## THËRRAS


### Mbledhjen inauguruese të Kuvendit të Komunës së Podujevës

Mbledhja mbahet më **01 dhjetor 2025**, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, ndërtesa e re e Komunës, duke filluar **në ora 10:30**

### Rendi i ditës

1. Hapja dhe kryesimi i mbledhjes nga anëtari më i moshuar i zgjedhur i Kuvendit
2. Ngritja e Komisionit për verifikimin e mandatit të anëtarëve të Kuvendit  
- Raporti i Komisionit për verifikimin e mandatit të anëtarëve të Kuvendit
3. Dhënia e Betimit nga anëtarët/et e zgjedhur të Kuvendit të Komunës
4. Dhënia e Betimit nga Kryetari i Komunës
5. Fjala e rastit e Kryetarit të Komunës

Nr.Prot. 02-060/01-0076144/25  
Podujevë,  
21 nëntor 2025



Kryetari i Komunës  
Shpejtim Bulliqi